



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Pritiljeno / Prodato Received / Delivery	02.02.2022	2	viti god year
Organ / Njesia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojçe Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SIMSHICK	498/2022		1/3



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1203/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca – kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Arben Mehmeti-anëtarë, me Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.1203/2021 të datës 21.12.2021 të parashtruar nga ankuesi me adresë Komuna e Obiliqit, kundër organit të punësimit Komuna e Obiliqit, në çështjen juridike “kompensim material”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nen paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 02.02.2022, mori këtë:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, shpallet jo kompetent për të vendosur për ankesën me numër A.nr.1203/2021 të datës 21.12.2021 të parashtruar nga ankuesi nga Obiliqi.

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Komunën e Obiliqit, me datë 21.12.2021, ka parashtruar ankesë me numër protokollit 6245/2021, të regjistruar me numër A.nr.1203/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër përgjigjes me shkrim të datës 15.06.2021 të organit të punësimit përmes të cilës ankuesit i është refuzuar kërkesa për kompensimin e shpenzimeve për vdekjen e anëtarit të ngushtë të familjes.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjen e Ankesave, me datë 29.12.2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit të Komuna e Obiliqit. Këshilli me datë 17.01.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë nga organi i punësimit se bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 6245/2021 të regjistruar me numër A.nr.1203/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen Nr.III-194 të datës 15.06.2021 të Komunës së Obiliqit; Certifikatë-Ekstrakt nga Regjistri Qendror i Gjendjes Civile E 23343927, Certifikatë e Vdekjes V 100327572 e datës 09.03.2020; Certifikatë e Vdekjes V 10209421 e datës 14.08.2018; Certifikatë e Martesës M 10617005 e datës 14.08.2018; Përgjigjen në ankesë të datës 17.01.2022; Vendimin Nr.1-13 i datës 26.02.2014; Vendimin Nr.II-62 të datës 29.01.2018; dhe Kontratën e Punës Nr.II/20 të datës 01.10.2015.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave gjatë administrimit të provave të lëndës ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës **nuk është kompetent** për të vendosur për ankesën me numër A.nr.1203/2021 të datës 21.12.2021 të parashtruar nga ankuesi *sepse:*

Bazuar në shkresat e lëndës, respektivisht Vendimin Nr.11-62 të datës 29.01.2018 të lëshuar nga Kryetari i Komunës së Obiliqit, rezulton se ankuesi mban pozitën e punës *Roje Pylli* në Drejtorin për Bujqësi dhe Zhvillim Rural pranë Komunës së Obiliqit.

Me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenin 2 paragrafi 3 përcaktohet se: *Nëpunës civil - është zyrtari publik në kuadër të Shërbimit Civil, i cili ushtron detyrën në një pozitë, duke filluar nga zyrtari profesional deri në pozitën e sekretarit të përgjithshëm në administratën e Presidentit, në administratën e Kuvendit, në Zyrën e Kryeministrit, në ministri, në agjenci ekzekutive, në agjenci dhe në një degë lokale të tyre, në administratën e institucioneve të sistemit të drejtësisë, në institucion të pavarur, në agjenci të pavarur, në administratën komunale dhe çdo nëpunës i përcaktuar drejtpërdrejt me ligj të veçantë, ndërsa me paragrafin 6 të këtij neni përcaktohet se: Nëpunës administrativo-teknik - dhe mbështetës është zyrtari publik, që kryen veprimtari ndihmëse, të mirëmbajtjes, ruajtjes, vozitjes, si dhe veprimtari të tjera të ngjashme në institucionet e administratës publike.*

Andaj, duke marr parasysh se ankuesi mban pozitën e punës *Roje Pylli* në Drejtorin për Bujqësi dhe Zhvillim Rural pranë Komunës së Obiliqit, Kolegji vlerëson se i njëjti ka statusin e nëpunësit administrativo-teknik dhe mbështetës, dhe si rrjedhojë vlerëson se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur për nëpunësit me status administrativo-teknik dhe mbështetës, sepse bazuar nenin 6 paragrafi 1 nen paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Këshilli është kompetent për të vendosur vetëm për nëpunësit civil dhe kandidatet për pranim në Shërbimin civil, siç është përcaktuar në nenin 2 paragrafi 2 nen paragrafi 2.1 dhe paragrafi 3 si dhe nenin 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas konstatimit se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e ankuesit, duke u bazuar në dispozitat e nenit 24 paragrafi 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, konstaton se zyrtaret publikë të cilët kanë statusin e *nëpunësit administrativo dhe mbështetës* kanë të drejtë të ankohen të punëdhënësi dhe më pas mund të fillojë kontest administrativ në gjykatën kompetente.



Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nënin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda A.nr.1203/2021

Rushit KAJTAZI

Procesmbajtës

Jeton KOCA

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit,
- Kryetarit të Komunës së Obiliqit;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Obiliqit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

